|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-896/2022</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>10.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 09.11.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1“Transporti i nxënësve dhe studentëve nga Syrigana në Uçë dhe anasjelltas”, Lot2 Transporti i nxënësve nga lagja e Ukisve, lagja Palokaj e tutje në shkollën Martin Camaj”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11985-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-089-221, nxjerr:

## V E N D I M

**1.THEMELOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1“Transporti i nxënësve dhe studentëve nga Syrigana në Uçë dhe anasjelltas”, Lot2 Transporti i nxënësve nga lagja e Ukisve, lagja Palokaj e tutje në shkollën Martin Camaj”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11985-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-089-221, dhe në komision caktohen.

- 1.1 Beqir Ibrahimaj,** Drejtorë në SHFMU “Tre Dëshmoret në Uçë, Kryesues i Komisionit,
- 1.2 Mimoza Kabashi,** Drejtorë në SHFMU “Martin Camaj në Gurrakoc , anëtar dhe
- 1.3 Shefqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit2, anëtar.

**2.** Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: Lot1“Transporti i nxënësve dhe studentëve nga Syrigana në Uçë dhe anasjelltas”, Lot2 Transporti i nxënësve nga lagja e Ukisve, lagja Palokaj e tutje në shkollën Martin Camaj”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

**3.** Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

**4.** Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

**5.** Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

**6.** Obligohen anëtarët e komisionit që në afatën me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

**7.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale për Arsim.

**8.** Vendimi është përfundimtar.

### Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj.Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës**  
**z.Illir FERATI**






|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-895/2022</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>10.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 08.11.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Blerja e pajisjeve-kondicionerëve për nevoja të QPS-së, shtëpisë se komuniteteve, DKA-së dhe Administratës Komunale”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11572-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-086-136, nxjerr:

## V E N D I M

**1.THEMELOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Blerja e pajisjeve-kondicionerëve për nevoja të QPS-së, shtëpisë se komuniteteve, DKA-së dhe Administratës Komunale”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11572-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-086-136, dhe në komision caktohen

- 1.1 Brahim Hetemaj,** Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësisë, Kryesues i Komisionit,
- 1.2 Florije Bytyqi,** Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Ulët, anëtar dhe
- 1.3 Haki Ibrahimaj,** Drejtor i Qendrës për Punë Sociale, anëtar.

**2.** Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: “Blerja e pajisjeve-kondicionerëve për nevoja të QPS-së, shtëpisë se komuniteteve, DKA-së dhe Administratës Komunale”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni:

**3.** Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

**4.** Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

**5.** Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

**6.** Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

**7.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shëndetësi.

**8.** Vendimi është përfundimtar.

### Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj.Zekije SUTAJ**

**Kryetari Komunës**  
**z.Illir FERATI**

|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-894/2022</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>10.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 09.11.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: "Punimi i kulmit në shkollën profesionale "Mithat Frasheri-Gurakoc" me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11987-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-088-521, nxjerr:

## V E N D I M

**1.THEMELOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: "Punimi i kulmit në shkollën profesionale "Mithat Frasheri-Gurakoc" me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11987-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-088-521, dhe në komision caktohen

- 1.1. **Januz Ahmetaj**, Zëvendës Drejtorë në SHMLP "Mithat Frasheri në Gurakoc, Kryesues i Komisionit,
- 1.2 **Naim Sadriu**, Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim, anëtar dhe
- 1.3 **Driton Alihajdaraj**, Zyrtar i Lartë i Prokurimit2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: "Punimi i kulmit në shkollën profesionale "Mithat Frasheri-Gurakoc", me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale për Arsim.

8. Vendimi është përfundimtar.

**Vendimi i dërgohet:**

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj.Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës**  
**z.Illir FERATI**




|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>01.Nr.Br.879/2022</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>10.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 38 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe nenin 12 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, shqyrtoj propozimin 05.Nr.801/22 të datës 01.11.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, për emërimin e përkohshëm të Drejtoreshës IP “Lulet e Jetës” në Vrellë, pas përfundimit të kontratës deri sa të kryhen procedurat e rekrutimit, nxjerr:

## V E N D I M

**1. znj.Mirjeta Beqiraj**, drejtoreshë deri me tani pranë IP “Lulet e Jetës” në Vrellë, me kualifikim profesororeshë e Pedagogjisë, emërohet përkohësisht në detyrat e punës së ushtruesit të detyrës së drejtorit në IP “Lulet e Jetës” në Vrellë.

**2.** Sipas pikës 1 të këtij vendimi **znj.Mirjeta Beqiraj**, do ti kryej detyrat e drejtorit me kompetenca të plota në pajtim me Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, deri në përfundim të procedurave të konkursit për përzgjedhje dhe emërim të drejtorit të këtij institucioni arsimor.

**3.** Paga bazë është 495.30 euro. Kodi i titullit DIR-7.8.

**4.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: znj.Mirjeta Beqiraj dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

**5.** Vendimi është përfundimtarë.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa pranë Komunës.

### Vendimi i dërgohet:

- znj.Mirjeta Beqiraj,
- PIP “Lulet e Jetës” në Vrellë,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj.Zekije SUTAJ**






|                                                                                   |                                                                       |                                        |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                        |  |
| <b>Republika e Kosovës<br/>Republika Kosovo<br/>Republic of Kosova</b>            | <b>01.Nr.Br.878/2022</b>                                              | <b>Data:<br/>Datum:<br/>10.11.2022</b> | <b>Komuna e Istogut<br/>Opština Istok<br/>Istog Municipality</b>                    |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 38 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe nenin 12 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, shqyrtoj propozimin 05.Nr.801/22 të datës 01.11.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, për emërimin e përkohshëm të Drejtoreshës së IP "Gëzimi Ynë", pas përfundimit të kontratës deri sa të kryhen procedurat e rekrutimit, nxjerr:

## V E N D I M

**1. znj. Fatmire Rugova**, drejtoresh deri me tani pranë IP "Gëzimi Ynë" në Istog, me kualifikim profesoreshe e Gjuhës Shqipe, emërohet përkohësisht në detyrat e punës së ushtruesit të detyrës së drejtorit në IP "Gëzimi Ynë" në Istog.

**2.** Sipas pikës 1 të këtij vendimi **znj. Fatmire Rugova**, do ti kryej detyrat e drejtorit me kompetenca të plotë në pajtim me Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, deri në përfundim të procedurave të konkursit për përzgjedhje dhe emërim të drejtorit të këtij institucioni arsimor.

**3.** Paga bazë është 495.30 euro. Kodi i titullit DIR-7.8.

**4.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: znj. Fatmire Rugova dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.


**5.** Vendimi është përfundimtarë.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa pranë Komunës.

### Vendimi i dërgohet:

- znj. Fatmire Rugova,
- IP "Gëzimi Ynë" në Istog
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
znj. Zekije SUTAJ**






|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSIEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>01.Nr.Br.877/2022</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>10.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 38 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe nenin 12 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, shqyrtoj propozimin 05.Nr.801/22 të datës 01.11.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, për emërimin e përkohshëm të drejtorit të shkollës “Hysni Zajmi” në Vrellë, pas përfundimit të kontratës pasi që i ka përfunduar kontrata deri sa të kryhen procedurat e rekrutimit, nxjerr:

## V E N D I M

1. **z.Beqir Ibrahimaj**, drejtor deri me tani i SHFMU “Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe” në Uçë, me kualifikim profesor i pedagogjisë, emërohet përkohësisht në detyrat e punës së ushtruesit të detyrës së drejtorit në SHFMU “Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe” në Uçë.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi **z.Beqir Ibrahimaj**, do ti kryej detyrat e drejtorit me kompetenca të plota në pajtim me Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, deri në përfundim të procedurave të konkursit për përzgjedhje dhe emërim të drejtorit të këtij institucioni arsimor.
3. Paga bazë është 495.30 euro. Kodi i titullit DIR-7.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: **z.Beqir Ibrahimaj** dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.
5. Vendimi është përfundimtarë.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa pranë Komunës.

### Vendimi i dërgohet:

- z.Beqir Ibrahimaj,
- SHFMU “Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe”,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**znj.Zekije SUTAJ**




|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>01.Nr.Br.876/2022</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>10.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 38 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe nenin 12 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, shqyrtoj propozimin 05.Nr.801/22 të datës 01.11.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, për emërimin e përkohshëm të drejtorit të shkollës “Hysni Zajmi” në Vrellë, pas përfundimit të kontratës deri sa të kryhen procedurat e rekrutimit, nxjerr:

## V E N D I M

**1. z.Sadik Bicaj**, drejtor deri me tani i SHFMU “Hysni Zajmi” në Vrellë, me kualifikim profesor i Gjuhës Shqipe, emërohet përkohësisht në detyrat e punës së ushtruesit të detyrës së drejtorit në SHFMU “Hysni Zajmi” në Vrellë.

**2.** Sipas pikës 1 të këtij vendimi **z.Sadik Bicaj**, do ti kryej detyrat e drejtorit me kompetenca të plota në pajtim me Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik, Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, deri në përfundim të procedurave të konkursit për përzgjedhje dhe emërim të drejtorit të këtij institucioni arsimor.

**3.** Paga bazë është 495.30 euro. Kodi i titullit DIR-7.8.

**4.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: **z.Sadik Bicaj** dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

**5.** Vendimi është përfundimtarë.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa pranë Komunës.

### Vendimi i dërgohet:

- z.Sadik Bicaj,
- SHFMU “Hysni Zajmi” në Vrellë,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**znj.Zekije SUTAJ**




|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-875/2022</b>                                                         | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>10.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.261/2022 të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi të datës 09.11.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin “Blerja e materialit fidanor dhe pajisje”, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **z.Fadil Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: z.Astrit Hajrizaj**, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për projektin: “Blerja e materialit fidanor dhe pajisje”, sipas planit Operativ, me numër të jashtëm prokurimi 633-22-9322-1-2-1/C648 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-070-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar Grup i operatorëve ekonomik “**N.P.SH**” **Fidanishtja &N.SH.T. AGRO-SISTEM**.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
5. Vendimi është përfundimtar.

#### Vendimi i dërgohet:

- z.Fadil Kabashi, Menaxher e kontratës,
- z.Astrit Hajrizaj, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**znj. Zekije SUTAJ**



Kryetari Komunës-ZKA  
**z.Illir FERATI**





|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01- 873/022</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>09.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-46862 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga znj.Burbuqe Pepaj, nga f.sh, Carallukë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-46862, e datës 31.10.2022, e parashtruar nga znj.Burbuqe Pepaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqindë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyres se Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e znj.Burbuqe Pepaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

znj.Burbuqe Pepaj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-46862 të datës 31.10.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Burbuqe Pepaj është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **500.00€ (pesëqindë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyres se Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

### Vendimi i dërgohet:

- Burbuqe Pepaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyres së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës  
 z.Illir FERATI





|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-872/022</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>09.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenin 11 paragrafi 5 dhe paragrafi 6 nënparagrafi 6.1,6.2,6.3 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën 04Nr.54/2022 të datës 09.11.2022, të parashtruar nga Drejtori Drejtorisë për Ekonomi, për kompensim për punë jashtë orari për z.Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave dhe i caktuar Zyrtar përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik, nxjerri:

## V E N D I M

**1. MIRATOHET:** kërkesa 04Nr.54/2022 e datës 09.11.2022, për kompensim për punë jashtë orari për z.Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave dhe i caktuar edhe Zyrtar përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik e për punë jashtë orarit të punës dhe ditëve të vikendit.

**2.** z.Ardon Arifaj, për punë jashtë orari të punës për 18 orë pune me 30% kompensohet në shumë prej 57.78€ (pesëdhjeteshtatë euro e shtatëdhjetë e tetë cent); për 10 orë pune me 50% ditëve të vikendit kompensohet në shumë prej 37.10€ (tridhjeteshtatë euro dhjet cent), e që gjithsejtë në shumë të përgjithshme **94.88€ (nëntëdhjetekatër euro e tetëdhjetetë cent).**

**2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e z.Ardon Arifaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe të përgjegjësiave.

**3.** Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyrtarja Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime.

**4.** Vendimi është përfundimtarë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve mbas ditës së pranimi të këtij Vendimi.

### Vendimi i dërgohet:

- z.Ardon Arifaj,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim,
- Emina Coković, Zyrtare Financiare për paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

**Kryetari Komunës**  
**z. Ilir FERATI**  


|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-870/022</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>09.11.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 17 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019), nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në Ligjin Nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, shqyrtoj kërkesën 01-034-44481 të datës 13.10.2022 të parashtruar nga Selvije Rexhaj nga fsh. Cerrcë Komuna Istogut, për qasje në dokumente private në lenden e Xhevdet Rexhaj dhe përmes emailit zyrtarë i referon Sektorit Ligjor të nxjerr:

### V E N D I M

#### Për refuzim për qasje në dokumente publike

**1. REFUZOHET:** kërkesa 01-034-44481 e datës 13.10.2022 e parashtruar nga Selvije Rexhaj, për qasje në dokumente publike, e cila ka kërkuar të ketë qasje në dokumente private në lenden e Xhevdet Rexhaj si me poshtë:

- 1.1. Certifikatën e pronës,
- 1.2. kopjen e planit dhe
- 1.3. kërkesën për leje ndërtimore për shtëpi në vitin 2003.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike e cila obligohet që Vendimin t'ja dërgoj Selvije Rexhaj,

3. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Selvije Rexhaj nga fsh. Cerrcë, Komuna Istogut, ka parashtruar kërkesën 01-034-44481 të datës 13.10.2022, për qasje në lenden e Xhevdet Rexhaj. me qellim të qasjes ne dokumente private siç janë: certifikatën e pronës, kopjen e planit dhe kërkesën për leje ndërtimore të vitit 2003.

I refuzohet kërkesa Selvije Rexhaj dhe nuk i lejohet qasja në dokumentet private në lenden e Xhevdet Rexhaj. Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si të tillë dhe pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës i propozoj Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj kërkesën e lartpërmendur për qasje në dokumente publike dhe e refuzon lejimin e qasjes së plotë në dokumente publike si në dispozitiv të këtij Vendimi.

